



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja (d) të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të nenit 28 paragrafi 2 pika (l) lidhur me nenin 29 paragrafi 2 pika (d), të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, e në zbatim të nenit 12, pika 2 të Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datën, 30.06.2023 miratoi këtë:

V E N D I M
Për shfuqizimin e Rregullores 01-Nr-209

Neni 1

Me këtë vendim shfuqizohet tërësisht Rregullorja për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të palestrës sportive “13 Qershori” në Suharekë me numër të protokollit 01-Nr-209, e datës 30.12.2005.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për kulturë, rini, sport dhe mërgatë dhe Drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet e Komunës së Suharekës.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-016-40548
Më datë 30.06.2023

